RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Xhevdet Bushi, ***Eksperti shqyrtues i jashtëm***	**02.06.2022**	**12.06.2022**	Nr. i lëndës: **166/22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.05.2022, OE.BOJKU HIDRAULIK - Pejë, ka parashtruar ankesë me nr: **166/22**, kundër Njoftimit mbi Anulimin e aktivitetit te Prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me pirunar te ri"** me nr te prokurimit**: KEK-21-2646-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – **Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**, lloji i kontratës: **Furnizim**, vlera e parashikuar e kontratës: **150,000.00 €**.

SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i **OSHP-së)**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

TE DHENAT MBI AKTIVITETIN E PROKURIMIT

Njoftimi për kontratë: 05.05.2021
Vendim i AK-se: 10.05.2022
Kerkesa per rishqyrtim: 13.05.2022
Vendimi i rishqyrtimit: 20.05.2022

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE – 166/22

Shpallja e procedurës ne e-prokurim:

Dispozitat e shkeluara te AK-se

1. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,
2. AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së 20 të RRUOPP-së,
3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,
4. AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së dhe 44 të RRUOPP-së
5. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,
6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së dhe nenin 39 të RRUOPP-së.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.
Pretendimet ankimore te OE ankues

Ky aktivitet i prokurimit ka filluar me rastin e njoftimit për kontratë i cili është bërë më datën 06.05.2021.
Hapja publike është bërë më datën 16.06.2021 ashtu siç ka qenë e paraparë me njoftimin për kontratë.
Njoftimi për vendimin e AK është bërë me datën 11.08.2021
Të pakënaqur me këtë vendim, Ne me datën 16.08.2021 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.
Me datë 19.08.2021 AK ka kthyer përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim të cilën e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ndërsa procesin e prokurimit e ka kthyer në Ri-Vlerësim.
Pas procesit të stërzgjatur të ri-vlerësimit, me datën 09.02.2022 AK publikon Njoftimin mbi Vendimin e AK-së duke mos ndryshuar asgjë nga vendimi i parë. Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullte kohor, me datë 14.02.2022 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së.
Me datë 23.02.2022 AK na ka kthye përgjigje në Kërkesën për Rishqyrtim ku kërkesën tonë e ka pranuar si pjesërisht të bazuar dhe lëndën e ka kthyer edhe një herë në rivlerësim.
AK ka përfundua procesin e ri-vlerësimit edhe për të dytën herë dhe më datë 10.05.2022 ka publikua Njoftimin mbi Vendimin e AK-së. Vendimi nuk ndryshonte nga ai i më hershmi andaj të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullt kohorë me datë 13.05.2022 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim për herën e tretë.
Me datë 20.05.2022 AK e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim të paraqitur nga ne andaj të pakënaqur me këtë veprim të AK-së, po parashtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së

Kriteri i vlerësimit ka qenë **çmimi më i ulët.**

Njoftimi për vendimin e AK është bërë me datën 11.08.2021
Të pakënaqur me këtë vendim, Ne me datën 16.08.2021 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.
Me datë 19.08.2021 AK ka kthyer përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim të cilën e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ndërsa procesin e prokurimit e ka kthyer në Ri-Vlerësim.
Pas procesit të stërzgjatur të ri-vlerësimit, me datën 09.02.2022 AK publikon Njoftimin mbi Vendimin e AK-së duke mos ndryshuar asgjë nga vendimi i parë. Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullte kohor, me datë 14.02.2022 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së.
Me datë 23.02.2022 AK na ka kthye përgjigje në Kërkesën për Rishqyrtim ku kërkesën tonë e ka pranuar si pjesërisht të bazuar dhe lëndën e ka kthyer edhe një herë në rivlerësim.
AK ka përfundua procesin e ri-vlerësimit edhe për të dytën herë dhe më datë 10.05.2022 ka publikua Njoftimin mbi Vendimin e AK-së. Vendimi nuk ndryshonte nga ai i më hershmi andaj të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullt kohorë me datë 13.05.2022 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim për herën e tretë.
Me datë 20.05.2022 AK e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim të paraqitur nga ne andaj të pakënaqur me këtë veprim të AK-së, po parashtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së

Ne vazhdim po ju njohim me faktet dhe argumentet që e mbështesin pretendimin tonë për shkeljet e dispozitave te LPP-së nga ana e AK-së.

Pretendimi 1: AK ka shkelur prapë nenin 7 të LPP-së gjatë procesit të ri-vlerësimit/vlerësimit të ofertave për herën e dytë/tretë duke mos respektuar kërkesat nga dosja e tenderit përkatësisht Aneksi 1 – Specifikimi Teknik si dhe përgjigjet e dhëna nga vet AK (*që sipas LPP-së automatikisht bëhen kërkesa të dosjes dhe duhet respektuar*) andaj ky veprim e shtynë këtë të fundit drejt trajtimit jo të drejtë të tenderuesve. OE që AK e kishte shpallur fitues dy herë më parë, i doli AK-së realisht i papërgjegjshëm ndërsa neve për kërkesa dhe kritere që i ka aprovuar vet përmes përgjigjeve në pyetjet e parashtruara nga ne na eliminon padrejtësisht andaj kjo konsiderohet diskriminim i hapur ndaj kompanisë tonë e që si veprim konsiderohet mos respektim dhe shkelje e plotë e nenit 7 të LPP-së.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderit tonë nuk i ka aplikuar drejt dhe saktë kërkesat nga Aneksi 1, dhe kërkesat e modifikuara gjatë sqarimit të dosjes së tenderit e gjithashtu nuk i ka shfrytëzuar as mundësitë ligjore për sqarimin e tyre. Kjo ka ndikuar që AK të mos veproj në përputhje me nenin 28 të LPP-së dhe me nenin 20 të RRUOPP-së.
Ajo që u tha më lartë tregon qartë se edhe gjatë ri-vlerësimit të dytë të tenderëve AK nuk i ka respektuar specifikimet teknike andaj konstatojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 28 të LPP-së.

Pretendimi 3: AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Pika 4 e këtij neni thotë se:

Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ky nen konsiderojmë se është shkelur edhe me rastin e ri-vlerësimit të dytë, sqarimit dhe krahasimit të tenderëve e posaçërisht tenderit tonë dhe tenderit të OE Profitech SHPK.

AK kësaj radhe, OE që herën e kaluar e kishte shpallur fitues, e ka cilësuar si të papërgjegjshëm duke ia kontestuar vetëm mosplotësimin e pozicionit 32, 37 dhe gjatësinë totale të pirunarit (5800mm), mirëpo ky OE posedon edhe disa mangësi tjera të cilat po i cekim më poshtë:

Ky OE ka dorëzuar katalog të prodhuesit ku për disa nga karakteristikat teknike të kërkuara nga AK nuk ka ofruar asnjë të dhënë që nënkupton se ato nuk janë plotësuar si dhe për pikën 37 të kërkesës së aneksit 1 ka ofruar të dhëna të ndryshme brenda për brenda katalogut. Ky OE e ka dorëzuar një dokument që e konfirmon se gjoja pajisja e tyre i plotëson të gjitha karakteristikat teknike të prodhuesit dhe që do mund të konsiderohej plotësim i katalogut por këtë dokument nuk e ka lëshuar prodhuesi por dileri i autorizuar. Kërkesa e AK-së lidhur me katalogun dhe dokumentet autentike të prodhuesit ishte kështu:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **1.Autenticitetit i produkteve dhe cilësisë reprezentues** **2.Mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe ose fotografive dhe vizatime të produkteve që duhet të furnizohen**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileriatëherë si dëshmi te sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve qe ofroni** **2. Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni. Ne katalog pjese te katalogut sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara**

Bazuar në kërkesën e tillë dokumenti që tregon plotësimin e karakteristikave teknike e që është i nënshkruar dhe vulosur nga **dileri** nuk është i vlefshëm sepse dileri nuk ka autorizim për diçka të tillë. Këtë e vërteton edhe konfirmimi i prodhuesit i cili flet vetëm për katalogun dhe decidivisht e thotë kështu:

Burim Morina

From: zhenbin@xcmg.com
Sent: Friday, October 8, 2021 1:26 PM
To: Burim Morina
Cc: Flamur Bekteshi; zhangkan
Subject: Re: FW: KEK-21-2646-1-1-1

Dear Burim,

We have been produce the model XCF1206.
The catalog attached is issued by our company. Our company is producing the model that EO has offered.

Best regards,

甄斌 Bin Zhen
徐州工程机械集团进出口有限公司欧洲部
XCMG IMP.&EXP.CO.,LTD
ADD: XCMG Headquarters Xuzhou Economic Development Zone, Jiangsu, China 221004

Rrjedhimisht sipas dokumentit teknik të prodhuesit siç është katalogu ku i njëjti nuk ndodhet në web faqen e prodhuesit, specifikimet teknike të kërkuara nga AK nuk plotësohen nga pajisja e paraqitur. Kërkesa për sqarim e AK-së drejtuar prodhuesit ka të bëje vetëm me atë se a është katalogu i lëshuar nga kompania prodhuese, por pavarësisht se prodhuesi ka deklaruar se katalogu është i tyre dhe ata e prodhojnë pajisjen sipas katalogut, pajisja dhe të dhënat në katalog janë në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Ky sqarim mbulon katalogun ndërsa karakteristikat teknike janë në kundërshtim me kërkesën e Aneks 1 prandaj ne pretendojmë se pajisja e ofruar nga kompania Profitech SH.P.K. nuk e plotëson aneksin 1 sipas kërkesave të AK-së. Nisur nga ky fakt konsiderojmë se OE në fjalë është edhe më

shumë i papërgjegjshëm në krahasim me atë si e cilëson AK-ja dhe si i tillë është dashur të eliminohet qysh herën e parë nga konkurrenca. Ja si duket një pjesë e dokumentit të dorëzuar nga ky OE që e ka lëshuar dileri pa të drejtën e prodhuesit dhe si i tillë nuk është dashur të konsiderohet i pranueshëm nga AK-ja

Technical specification

Forklift 12 t - 15 t

Nr. / No	Description of technical features	Requested	Offered technical specification
1.	Power source	diesel	diesel
2.	Load capacity (kg)	min 12000 – max 15000	12000
3.	Operator type	Adjustable or Suspension seat	Adjustable seat
4.	Load center distance (mm)	min 600 mm	600 mm
5.	Load distance, axle to fork face (mm)	min 730-max 830 mm	730mm
6.	Wheelbase (mm)	min 2800 – max 3300 mm	3000mm
7.	Forklift weight	without load (kg): 14500 – 18500	15300
8.	Axle loading with maximum load, front/rear (kg)	Min 23900/2500/max 31500/3200 kg	24621/2679
9.	Axle loading without load, front/rear (kg)	min 6800/7800 – max 8500/10000 kg	7273/8027
10.	Tires	Pneumatic	Pneumatic
11.	Tire dimensions, front	min 10.00-20-18PR	10.00-20-18PR
12.	Tire dimensions, rear	min 10.00-20-18PR	10.00-20-18PR
13.	Number of wheels, front/rear (x=driven)	4x/2	4x/2
14.	Track width (centre of tires), front (mm)	min 1700 mm	1724
15.	Track width (centre of tires), rear (mm)	min 1850 mm	1850
16.	Rated output (kW)	Min 110 Kw	118
17.	Rated speed (rpm)	Min 2000 rpm	2200

Dileri i autorizuar nuk posedon autorizim për modifikim të karakteristikave teknike të pajisjeve që i shet andaj ky dokument sipas ligjit të prokurimit publik e ka vlerën zero. Kjo na jep mjaftueshëm arsye për të besuar se katalogu është i manipuluar duke ndryshuar të dhëna në të. AK prapë lajthitet ku komisioni vlerësues i cili është plotësisht përgjegjës për të kontrolluar secilin detal të dhënë, nuk e ka kryer punën si duhet dhe ka dështuar në nxjerrjen e një konstatim meritor për tenderuesin në fjalë ku nuk i ka potencuar edhe shkelje tjera që i posedon në tenderin e tij. Edhe më jo serioz e bënë prodhuesin e tillë deklarimi se gjoja katalogu është i joni ashtu siç është paraqitur nga ofertuesi kur në të vërehen gabime shumë të mëdha. Kjo është plotësisht e papranueshme dhe shkelje e rëndë e nenit 59 të LPP-së nga ana e komisionit vlerësues sepse po shihet se janë lajthitur nga të dhëna manipuluese dhe kanë lëshuar gabime themelore në procesin e vlerësimit.

Përpos tjerash OE Profitech SHPK nuk ka ofruar të dhëna fare në katalogun autentik të prodhuesit as për pikat:

24.	Operating pressure for attachments (bar) Presioni I operimit për shtojcat (bar)	Min 140 bar
25.	Oil flow for attachments (l/min) Rrjedhja e vajit për shtojca (l/min)	Min 100 (l/min)

41.	Full lining, optional heater with defrosting and air conditioning Rreshtim dhe veshje e plotë, ngrohës opsional me shkrirje dhe klimatizim
42.	Cabin has flat windows for easy and cost effective service replacement Kabina ka dritare të sheshta për zëvendësim të thjeshtë dhe me kosto efektive të shërbimit

Në këtë katalog mungojnë të dhënat për pikën 3 të aneksit 1 – ku është kërkuar që ulësja të jetë **Ulëse rregulluese ose ulëse me amortizer - Adjustable or Suspension seat.** OE në katalogun e prodhuesit nuk e ka ofruar fare këtë informatë ndërsa në specifikimin teknik të nënshkruar dhe vulosur nga dileri, e ka ofruar vetëm si **Adjustable seat** që tregon se nuk e plotëson karakteristikën e kërkuar nga AK.

Mungesa e të dhënave të tilla në katalogun e prodhuesit nënkupton se pajisjes së tillë i mungojnë karakteristikat e tilla dhe që sipas kësaj del të jetë pajisje që nuk i plotëson shumë nga karakteristikat e kërkuara nga AK në Aneksin 1, e jo vetëm ato që i ka potencuar komisioni i vlerësimit. Mungesat e tilla në specifikime teknike e bëjnë OE në fjalë edhe më shumë të papërgjegjshëm.

AK ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së edhe me rastin e ri-vlerësimit të tenderit tonë sepse na ka eliminuar për dy kërkesa që janë plotësisht sipas Aneksit 1 dhe përgjigjeve të dhëna nga vet AK.
Ja si duket arsyeja e eliminimit tonë:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye:

Poz. 11. Dimensioni i gomave të përparme është kërkuar: min 10.00-20-18PR, OE në ofertën e tijë na ka ofruar: 10.00-20, ku me anë të së cilës nuk është saktësuar lloji i mbështjellësve e që është dashur të jetë 18PR.

Poz. 12. Dimensioni i gomave mbrapa është kërkuar: min 10.00-20-18PR, OE në ofertën e tijë na ka ofruar: 10.00-20, ku me anë të së cilës nuk është saktësuar lloji i mbështjellësve e që është dashur të jetë 18PR.

Poz. 26. Sipas specifikimit teknik në DT. lartësia me direk të ulur është kërkuar max: 3000[mm], OE në ofertën e tijë na ka ofruar: 3170[mm], ku teknikisht nuk i plotëson kushtet sipas specifikimit teknik në DT

Sqarim për pozicionin 26, per kete pozicion janë dhënë tri përgjigje të ndryshme.
Më poshtë i paraqesim tri përgjigjet e ndryshme për pozicionin 26-të:
Përgjigjet ne pyetjet sqaruese për OE 1.
Poz.26. Lejohet lartësia me direk te ulur max 3170 mm

Përgjigjet ne pyetjet sqaruese për OE 2.
Poz.26. Po mund te jete lartësia me direk te ulur max 3040 mm .

Përgjigjet ne pyetjet sqaruese për OE 3.
Poz.26. Jo nuk mund te jete max 3445 mm. Duhet te jete max 3000 mm sipas specifimkimit teknik te detyrueshëm ne dosje te tenderit.

Sa i përket gomave ne kemi ofruar me numër të saktë të dy llojet e gomave(para dhe mbrapa) pra kemi ofruar gomat me karakteristikat kryesore **10.00-20** por vetëm nuk e kemi saktësuar llojin e mbështjellave të penjve e që janë dy lloje (16PR dhe 18PR). Me vet faktin se ne jemi deklaruar që specifikimet e pajisjes që ne ofrojmë i plotësojnë të gjitha kërkesat e Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit, AK nuk ka pasur të drejt të na eliminoj për këtë çështje sepse kjo nënkupton që pajisja jonë do të liferohej me goma sipas kërkesave të AK. Sipas nenit 72 të LPP dhe 39 të RRUOPP-së shumë qartë thuhet se:

*Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë **jo i plotë** ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.*

Me që ne nuk kemi dhënë ndonjë vlerë apo shifër lidhur me kërkesën e tillë e cila bie ndesh me kërkesën e AK-së por vetëm nuk e kemi përcaktuar a do jenë 16PR apo 18PR si dhe me që e kemi dorëzuar deklaratën lidhur me plotsueshmërinë e specifikimeve teknike, AK është dashur të na kërkoj sqarime lidhur me këtë mungesë të informacionit apo të hulumtoj vet në internet tek faqja e prodhuesit për t'a siguruar informatën e tillë. Mos sqarimi i kësaj pike AK-në e shtynë drejt shkeljes së nenit 59.4 dhe 72 të LPP-së si dhe drejt shkeljes së nenit 39 të RRUOPP-së. Ja si duken të dhënat për llojin e gomave tek linku i prodhuesit të pajisjes:

http://www.heliforklifts.co.nz/wp-content/uploads/2018/02/CPCD-120A-FLYER.pdf

Më poshtë po e paraqesim edhe vizualisht se si duken këto të dhëna:



Edhe për sa i përket lartësisë maksimale me direk të ulur që në dosje është kërkuar max3000mm e që ne e kemi ofruar me lartësi 3170mm duhet sqaruar se përmes pyetje përgjigjeve AK na e ka lejuar që kjo lartësi me direk të ulur mundet të shkoj edhe deri në max3170mm përkatësisht max3200mm. Ja dëshmia:

Pergjigjjet ne pyetjet sqaruese per OE 1.

Poz.19. Lejohet shpejtesia min 25/27 km/h

Poz.20. Lejohet min 0.35/0.40 m/s.

Poz.21. Nuk lejohet min 0.37 m/s / ne dosje eshte kerkuar shpejtesia e uleje me/pa ngarkes te jete min 0.35/045 m/s.

Poz.26. Lejohet lartesia me direk te ulur max 3170 mm

Per te gjitha pozicionet tjera duhet t'ju permbaheni Dosjes se tenderit dhe specifikimit teknik te detyrueshem .

Pergjigjjet ne pyetjet sqaruese per OE 3.

.
.
.

Poz.42 . Mund te jete ashtu siq e ka afruar ky OE , ose sipas specifikimit teknik te detyrueshem ne dosjen e tenderit.

Gjatesia e pirunarit komplet me piruna duhet te jete L =max 5800 mm per shakak te pengesave me manipulim ne objektet mbrenda (hapesirat e ngushta dhe pengesat e konstuksioneve metalike ne objekte te mullinjet).

Laretsia e pirunarit sbashku me trarin ne poziten ulur duhet te jete H=max 3200 mm sic eshte cekur ne specifikimin ne dosje te tenderit.

Pra eliminimi jonë për këto mangësi bie plotësisht në kundërshtim me kërkesat e AK-së të modifikuara përmes pyetje përgjigjeve e që sipas ligjit automatikisht bëhet mandatore për OE konkurrent si dhe bie ndesh edhe me të drejtën dhe detyrimin që ja japin AK-së neni 59.4 dhe 72 i LPP-së si dhe neni 39 i RRUOPP-së për të sqaruar tenderët që kanë mungesë informacioni.
AK tenton të në nxjerr të papërgjegjshëm për diçka që e ka lejuar vetë dhe për diçka që s'ka aspak rendësi pasi që mundet të sqarohet shumë lehtë sipas dispozitave ligjore të parapara për këtë qëllim. Nga këto veprime të Komisionit të Vlerësimit vërehet shumë mirë sjellja e tyre tendencioze kundrejt neve sepse na penalizon për një të dhënë që shumë prodhues nuk e vendosin fare nëpër katalogje pasi që dihet botërisht që pajisjet me ngarkesa, i kanë gomat me mbështjella (18PR) dhe se gomat me mbështjella (16PR) nuk lejohen fare. Pra neve na eliminon edhe përkundër që ne kemi dhënë deklaratën mbi përputhshmërinë e Specifikimeve Teknike të ofruara me ato të kërkuara. Kjo është shumë absurde dhe plotësisht e pakuptimet pasi që AK tenton që të keqpërdor mjetet financiare dhe ky veprim bie plotësisht ndesh me nenin 1 dhe 6 të LPP-së. AK shkon edhe më tej ku përpiqet që përgjigjen e dhënë shumë saktë në pyetjen tonë na ngatërroj me një përgjigje pa lidhje në një pyetje që nuk kishte të bëjë me lartësinë e pajisjes me tra të ulur. Shikojeni me vëmendje përgjigjet dhe do ta kuptoni që arsyetimi i AK-së është i pa bazuar dhe i pa krahasueshëm në mes përgjigjes në pyetjen tonë dhe asaj që thirret në gjoja gabim.

Pas krejt kësaj shihet se mos konstatimi i të gjitha mangësive në tenderin e OE Profitech SHPK dhe mos respektimi i të gjitha kërkesave të dosjes së tenderit dhe Aneksit 1, konsiderojmë se AK ka bërë shkeljen e plotë e nenit 59 të LPP-së si dhe shkelje të të gjitha dispozitave të ligjit që flasin për vlerësimin, sqarimin dhe krahasimin e drejtë të tenderëve sipas kërkesave të parapara në dosjen e tenderit. Shkeljen e këtyre neneve AK e ka bërë edhe me rastin cilësimit të tenderit tonë si të papërgjegjshëm duke aplikuar kritere që vet i ka lejuar përmes pyetje/përgjigjeve dhe duke mos kërkuar sqarime për paqartësi që i ka pasur e që sipas nenit 59.4 të LPP-së munden të konsiderohen edhe si gabime minore.

Pretendimi 4: AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së dhe nenin 44 të RRUOPP-së pasi që edhe përkundër se **nuk** janë plotësuar kërkesat e pikës 2.1 të nenit 62 të LPP-së dhe ajo e pikës 6 të nenit 44 të RRUOPP-së, AK e anulon procedurën e prokurimit duke u thirrur padrejtësisht pikërisht në këto dispozita ligjore. Nisur nga sqarimet e mësipërme ku shihet qartë se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të gjitha modifikimet e specifikimeve teknike të bëra me pyetje/përgjigje kuptohet dhe konstatohet se AK ka anuluar tenderin pa bazë ligjore dhe në kundërshtim të plotë me realitetin që mbretëron në dokumentacionin e tenderit tonë. Ky veprim bie ndesh plotësisht me nenin 62 të LPP-së dhe me nenin 44 të RRUOPP-së.

Pretendimi 5: AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me këtë nen. Paragrafi 2.2 dhe paragrafi 2.4 i nenit 69 e përshkruan se cilat janë dëshmitë që mund të kërkohen në rastet e tenderëve të tillë. Këtë e ka bërë AK dhe ka vendosur kërkesa lidhur me katalogjet dhe me specifikimet teknike mirëpo ato nuk i ka respektuar ashtu si duhet gjatë vlerësimit të tenderëve. Kjo tregon se AK nuk ka bërë vlerësim sipas kërkesave dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar as nenin 69 të LPP-së.

Pretendimi 6: AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së dhe 39 të RRUOPP-së pasi që gjatë vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderëve i ka aplikuar dispozitat e tilla në mënyrë selektive.
AK nuk ka respektuar dispozitat e tilla sa i përket një pike të pa definuar nga ne dhe mos aplikimi i dispozitave të këtij neni e shtynë AK-në drejt trajtimit jo të barabartë të OE dhe aplikim të ligjit në mënyrë selektive. Sjellja diskriminuese ndaj neve me mos kërkim sqarimi, tregon se AK përpos shkeljes së nenit 1, 6 dhe 7 të LPP-së po tenton të shkelë edhe nenin 59.4, 62 dhe 72 të LPP-së si dhe nenin 39 të RRUOPP-së duke tentuar ta anuloj tenderin edhe pse e ka një OE plotësisht të përgjegjshëm.

Bazuar në krejt këtë që theksuam më lart shpresojmë dhe besojmë që pas një verifikimi të tërë procesit të prokurimit, do të vërtetohen pretendimet tona andaj kërkojmë nga OSHP që të merr:

V E N D I M

APROVOHET si e **bazuar** ankesa e OE **"NPT Bojku Hidraulik"** lidhur me tenderin **"Furnizim me pirunar të ri"** i iniciuar nga **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (*Njoftimi për Anulim të Tenderit*) dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim.**
Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e ligjit dhe rregullave lidhur me vlerësimin e tenderëve ku realisht më pas do duhej që **Fitues** të shpallej OE **"NPT Bojku Hidraulik"**

DËMET MATERIALE

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, me një përvojë të madhe në këtë fushë.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65; 2.Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit; 3.Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit;	**1.Një deklarata nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit; Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë, pika 2, dhe 3 do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet.**

Përshtatshmëria profesionale	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2.Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit; 3.Regjistrimi i numrit fiskal	**1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit); 2.Kopja e certifikatës TVSH-se; 3.Kopja e certifikatës numrit fiskal.**

Kapaciteti teknik dhe professional	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Autenticitetit i produkteve dhe cilësisë reprezentues 2.Mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe ose fotografive dhe vizatime të produkteve që duhet të furnizohen 3.Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet	**1.Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileriatëherë si dëshmi te sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve qe ofroni** **2. Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni. Ne katalog pjese te katalogut sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara** **3.Certifikata (Certifikimi i prodhuesit për kualitet sipas ISO 9001 2015)**

Sigurimi i tenderit – 3,000.00 € për 120 ditë kalendarike

Kriteret e kerkuara nga AK-ja (per pretendimet qe ka OE ankues):

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni ri-vlerësues ka konstatuar si në vijim:
Filloi N/A
Perfundoi N/A
(Tëpërshkruhetvetëmvlërësimi i ofertëssë OE ankues /ofertave, përtë cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

--

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet njëvlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MË PARSHME TË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

- **NA**

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PERGJIGJE NE PRETENDIMET ANKIMORE TE OE ANKUES: 166/22

Sqarimi nr.1

Lidhur me pretendimin e parë ankimore te OE ankues, se AK ka shkelur nenin 7 te LPP-se, duke e shpallur fitues dy here radhazi OE e njejte.

OE ankues pretendon se AK nuk i ka repspektuar kriteret e kerkuara te FDT-se, sepse ka shpallur dy here radhaz OE e njejte fitues te ofertes.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, AK e ka shpallur fitues dy here radhazi OE e njejte, por ankesa ne fjale ka te beje me anulimin e aktivitetit dhe jo kunder ndonje OE.

Kriteret e kerkuara ne FDT dhe Njoftim per kontrate duhet te merren per baze per vleresimin e Ofertave dhe komisioni i vleresimit duhet te vleresoj konform kritereve te kerkuara si ne njoftim asshtu edhe ne FDT dhe te rekomandohet per kontrate nje OE qe i ploteson kriteret e kerkuara.

Sqarimi nr.2

Pretendimi i i dyte ankimor i OE ankues eshte se AK ka bere shkeljen e nenit 28 te LPP-se, dhe nenit 44 te RrUOPP-se.

Gjate vleresimit te tenderit, komisioni i vleresimit duhet te bej vleresimin e ofertave sipas nenit 59 te LPP-se, dhe duhet ti merr parasysh specifikat e kerkuara dhe çdo sqarim (pyetje-pergjigje) te kerkuar nga ndonje OE dhe te pranuar nga AK.

Pra, ne rastin konkret ka disa pyetje dhe pergjigje qe AK i ka pranuar sipas kerkesave te bere nga OE e interesuar.

Autoriteti Kontraktues ka qene dasht qe gjate vleresimit ti merr parasysh pos kritereve te kerkuara edhe sqarimet e kerkuara se bashku me specifikat e percaktuara ne dosjen e tenderit.

AK duhet ti merr parasysh ne proceduren e vleresimit te ofertes.

Sqarimi nr.3

Lidhur me pretendimin e trete ankimor te OE ankues, se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Pika 4 e këtij neni thotë se:

Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ky nen konsiderojmë se është shkelur edhe me rastin e ri-vlerësimit të dytë, sqarimit dhe krahasimit të tenderëve e posaçërisht tenderit tonë dhe tenderit të OE Profitech SHPK. AK kësaj radhe, OE që herën e kaluar e kishte shpallur fitues, e ka cilësuar si të papërgjegjshëm duke ia kontestuar vetëm mosplotësimin e pozicionit 32, 37 dhe gjatësinë totale të pirunarit (5800mm), mirëpo ky OE posedon edhe disa mangësi tjera të cilat po i cekim më poshtë:

Ky OE ka dorëzuar katalog të prodhuesit ku për disa nga karakteristikat teknike të kërkuara nga AK nuk ka ofruar asnjë të dhënë që nënkupton se ato nuk janë plotësuar si dhe për pikën 37 të kërkesës së aneksit 1 ka ofruar të dhëna të ndryshme brenda për brenda katalogut. Ky OE e ka dorëzuar një dokument që e konfirmon se gjoja pajisja e tyre i plotëson të gjitha karakteristikat teknike të prodhuesit dhe që do mund të konsiderohej plotësim i katalogut por këtë dokument nuk e ka lëshuar prodhuesi por dileri i autorizuar. Kërkesa e AK-së lidhur me katalogun dhe dokumentet autentike të prodhuesit ishte kështu:

Lidhur e pretendimin ankimor te OE ankues, se Autoriteti Kontraktues, e ka shpallur te papergjegjshem, OE qe e kishte rekomanduar dy (2) here per kontrate, por tani me ky OE del i papergjegjshem, sepse nuk i ploteson kriteret e kerkuara te specifikimi teknik.

Me kete AK duhet ti trajtoj operatoret njejte sipas nenit 7 dhe 59 te LPP-se, duke mos favorizuar apo diskriminuar asnje OE, sepse te gjithe OE duhet te trajtohen barabarte nga Autoritetet Kontraktuese, poashtu edhe AK duhet ti merr parasysh te gjitha sqarimet qe jane bere nga AK ne procesin e tenderimit, dhe po ato sqarime duhet te merren parasysh gjate vleresimit te tendereve.

Poashtu lidhur me pretendimin se OE ka autorizimi nga dileri, ne kerkesen e FDT-se kerkohet te Kapaciteti Teknik dhe Profesional:

Kerkesa 1: Autenticiteti i produketeve dhe cilesise reprezentuese

Deshmia 1: Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nese autorizimi eshte nga dileri atehere si deshmi te sjellet kontrate apo autorizim ne mes te dilerit dhe prodhuesit) per shitjen e produkteve qe ofroni.

Ne rastin konkret me Njoftimin mbi Vendimin e AK-se, rezulton se te gjithe OE jane te papergjegjshem dhe Anulohet aktiviteti. Pra, me kete rast edhe OE qe pretendon OE ankues eshte i papergjegjshem dhe anulohet i tere aktiviteti dhe me kete nuk ka asnje fitues te ofertes.

Me kete AK duhet ti vleresoj ofertat sipas nenit 59 te LPP-se dhe me kete duhet te krahason me sqarimet dhe kriteret dhe te trajtohet konform kritereve.

Bazuar ne Letren standarde per OE te eliminuar, OE ankues eshte eliminuar ne keto pozicione:

Poz.11– Dimensionet e gomave te perparme, ne FDT eshte kerkuar **goma 10-20-18PR**, por gjate ***pyetjeve/pergjigjeve per OE 2***, **eshte lejuar 10-20-16PR**, por **OE ankues ka ofertuar** me **goma 10-20**, per kete AK mund te kerkoj sqarime sipas nenit 72 te LPP-se.

Poz. 12 – Dimensionet e gomave te pasme, ne FDT eshte kerkuar **goma 10-20-18PR**, por gjate ***pyetjeve/pergjigjeve per OE 2***, **eshte lejuar 10-20-16PR**, por **OE ankues ka ofertuar** me **goma 10-20**, per kete AK mund te kerkoj sqarime sipas nenit 72 te LPP-se.

Poz.26 – Lartesia me direkt te ulur eshte kerkuar max.3000 mm, por OE e ka ofruar 3170 mm, ku teknikisht nuk i ploteson kushtet sipas specifikimit teknik ne DT.

Por, ne pyetje/pergjigjet qe jane leshuar nga AK, konkretisht te Pyetjet/Pergjigjet per **OE 1 thuhet**: "Lejohet lartesia me direkt te ulur max.3170 mm"

Pra, per poz.11 dhe 12 OE nuk e ploteson sipas kerkeses se FDT-se, dhe AK mund te kerkoj sqarime shtese,

Per poz.26 OE ankues e ploteson kriterin

Sqarimi nr.4

Pretendimi i katert ankimor i OE ankues, eshte se AK ka shkelur nenin 62 te LPP-se, duke e anuluar aktivitetin dhe duke mos i vleresuar ofertat sipas nenit 59 te LPP-se, nenin 69 te LPP-se dhe nenin 72 te LPP-se, por ka anuluar aktivitetin.

Me kete rast AK duhet ti merr parasysh te gjitha kriteret e kerkuara, duke respektuar edhe kursimin e buxhetit sipas nenit 1 dhe 6 te LPP-se, dhe duhet te merren parasysh kriteret sipas nenit 69 dhe per cdo paqartesi AK mund te kerkoj sqarime sipas nenit 72 te LPP-se.

Autoriteti kontraktues, duhet te kete parasysh kursimit e buxhetit dhe te respektoj te gjitha kriteret e percaktuara ne FDT dhe NJK, poashtu edhe duhet ti merr parasysh sqarimet apo pyetjet shtese te parashtruara gjate procesit te tenderimit.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE-së të aprovohet pjeserisht e bazuar dhe AK te kthen lenden ne rivleresim dhe gjate rivleresimit te vleresohen ofertat konform nenit 59 te LPP-se, dhe AK mund te kerkoj sqarime sipas nenit 72 te LPP-se dhe ne rast se sqarimet e kerkuara mund ta plotesojne kriterin e kerkuar (Gomat e perparme poz.11 dhe Gomat e pasme poz.12) , AK te vazhdoj me tutje me aktivitetin dhe ne rast se OE ankues nuk e ploteson kriteret me sqarimet shtese AK te anuloj aktivitetin e prokurimit.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **AK-KEK**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues - **OE. Bojku Hidraulik - Pejë**